



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
ZËDHËNËSI**

Tiranë, më __ / __ / 2014

Njoftim për Shtyp

KLSH KALLËZON NË PROKURORI

**ISH-DREJTORIN E DREJTORISË SË SHËRBIMIT PYJOR TIRANË DHE DISA
INSPEKTORË PYJESH**

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të Programit të auditimit nr. 59/1, datë 27.01.2014 dhe nr. 59/8, datë 21.04.2014, ka ushtruar auditim në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Tiranë, me objekt auditimi: “Zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në veprimtarinë ekonomiko-financiare dhe vlerësues” për aktivitetin e kryer në periudhën 2012-2013.

Në përfundim të këtij auditimi kanë rezultuar disa mangësi dhe shkelje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për të cilat KLSH i ka rekomanduar Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Tiranë 28 masa organizative dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga subjektet të cilat kanë marrë fond pyjor me qira.

Njëkohësisht i ka rekomanduar Ministrisë së Mjedisit 18 masa organizative dhe propozimin për ndryshim të kreut IV të Kodit Penal, pasi një nga agresionet më të mëdha mjedisore që po vuan vendi ynë është edhe prerja e pakontrolluar e pyjeve.

Gjithashtu nga auditimi i dokumenteve të vëna në dispozicion, rezultoi se:

1. H.G. në cilësinë e ish-drejtorit ka kryer veprime dhe mosveprime të kundërligjshme, të cilat bazuar në gjetjet dhe aktet e administruara në dosjen e auditimit, bien në kundërshtim referuar ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar dhe ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për rrjedhojë evidentohet se:

- Me neglizhencën e tij dhe të administratës së shërbimit pyjor gjatë viteve 2012-2013, janë krijuar dëme në pyje në vlerën prej **73,6 milion lekë**, nga kjo në zonë të mbrojtur **61,9 milion lekë**, duke mos zbatuar detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar.

- Për moszbatim të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, VKM nr. 402, datë 21.06.2006 “Për shpalljen e ekosistemit natyror të “Malit të Dajtit Park Kombëtar (me sipërfaqe të zgjeruar)”, dhe urdhrit të ministrit të MMPAU nr. 160, datë 24.01.2008 “Për zbatimin e ligjshmërisë”, i dalë në zbatim të ligjeve dhe vendimit të mësipërm, për ndërprerjen e aktivitetit të 13 subjekteve private që shfrytëzojnë gurin gëlqeror në Zonën e Mbrojtur “Mali i Dajtit”.

- Për lejimin e vazhdimit të aktivitetit në mënyrë të kundërligjshme të 34 subjekteve të cilat kanë ndërtuar objekte në fondin pyjor kullor duke krijuar një dëm ekonomik prej **54,2 milion lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (neni 199/a-Ndërtim i paligjshëm dhe neni 200-Pushtimi i tokës, të cilët përcaktojnë shprehimisht: “Objekt i kundërvajtjes penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar regjimin juridik të tokës d.m.th. përdorimin e saj sipas destinacionit, të mbrojtura posaçërisht në legjislacionin penal nga veprimet kriminale”.

- Duke treguar neglizhencë të theksuar në zbatimin të VKM nr. 516, datë 06.07.2011 “Për heqje nga fondi pyjor e kullor të sipërfaqeve nga ngastrat e ekonomisë pyjore Fagë dhe Krrabë-Gurrë, Tiranë që do të përdoret nga shoqëria “X-Y” sh.p.k. për ndërtimin e HEC-ve, ku në pikën 1 të këtij vendimi, përcaktohet sipërfaqja që hiqet prej **27,55 ha**, për shkak të ndërtimit të rezervuarit dhe digës, si dhe sipërfaqja prej **1,9 ha** për ndërtimi hidrocentrali. Gjithsej sipërfaqja prej **29,45 ha**. Në pikën 4 të këtij vendimi, theksohet se me hyrjen në fuqi të këtij vendimi subjekti “X-Y” sh.p.k. brenda **3 viteve**, me fondet e veta duhet të pyllëzojë **10 ha** pyje në ngastrat e përcaktuara nga DSHP, në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore. Është parashikuar që për vitin 2011-2012 të mbillen **3 ha**, për 2012-2013 të mbillet **3 ha** dhe për vitin 2013-2014 të mbillet **4 ha**. Nga auditimi rezultoi se subjekti “X-Y” sh.p.k. deri në përfundim të periudhës së auditimit nuk ka realizuar asnjë ha mbjellje të planifikuara sipas VKM së mësipërme.

II. - Për dëmet e krijuara në ngastrat e shfrytëzimit në “Parkun Kombëtar Mali i Dajtit” dhe Peizazhin e Mbrojtur “Mali me Gropa-Bizë-Martanesh”, ku është konstatuar se janë shkaktuar prerje e dëmtime të mëdha masive të këtyre pyjeve pa leje të organeve pyjore, përvetësim material drusor nga kundërvajtës të pyjeve, me një vlerë prej **32,3 milion lekë**, shkelje të cilat bien ndesh me ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8906, datë 06.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar dhe janë ngarkuar me përgjegjësi inspektorët e pyjeve: I.F; E.S; M.A; Y.B; A.B dhe B.S. Dëmet e shkaktuara në këto zona kanë ardhur si rezultat i mosveprimeve dhe moskryerjes së detyrave nga punonjësit e ngarkuar institucionalisht me ato detyra dhe në zbatim të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, këta kanë toleruar dhe mos ndëshkuar veprimet e paligjshme të subjekteve apo individëve e si rrjedhojë

prezumohet të kenë kryer konsumin të shpërdorimit të detyrës, parashikuar sipas nenit 248 i Kodit Penal.

Për shkeljet e mësipërme janë ngarkuar me përgjegjësi dhe është bërë kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë ndaj H.G. në cilësinë e ish-drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor Tiranë dhe inspektorët e pyjeve I. F; M. A; Y. B; A. B; dhe B. S. të cilët në mospërmbushje të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të dispozitave të mësipërme ligjore, kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duke i përcjellë prokurorisë të gjitha provat dhe dokumentacioni përkatës.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT